



“**RUAJU,
MOS TË KAPI KJO LUTJE!**”



**FEJA NË INDI
DHE DEVIJIMET E SAJ NË BESIM**



**SI TË VAZHDOJMË
PAS RAMAZANIT?**

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative


Viti 24 - Nr. 4 (278), Prill, 2026

www.myftinia-shkoder.org



MYFTINIASHKODER1990

Kalaja e Drishtit, KU ISLAMI PREJ SHEKUJSH E SHEKUJSH KA GJETUR VEND



Xhamia e Kalasë së Drishtit

KRYETARI I KOMUNITETIT MUSLIMAN
SHQIPTAR NË ZVICËR VIZITOI SHKODRËN

MYFTIU: “KËSHILLAT E PAJTIMTARËVE
DUHET TË JENË VIGJILENTË
NË ÇDO XHAMI!”

MYFTIU I SHKODRËS LIGJËROI
NË XHAMINË MBRET TË BERATIT

IMAMI I XHAMISË “EBU BEKËR”,
H. IDMIR PLAKU,
“MIRËNJOHJE” NGA KMSH!

NË MËSHIRË TË ALLAHUT,
H. HIQMET BEKTESHI!

XHAMIA MË E VJETËR NË EVROPË
MBI NJË KODËR QË RUAN
HISTORINË E ANDALUZISË



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

EDHE DY MINARE TË REJA PO I SHTOHN SHKODRËS!

“Allahu ekber”, mbetet fjalëkalim me të cilin janë ndërtuar civilizime dhe është ndezur shpresa e humbur, kudo e përherë!

Me “Allahu ekber” hapim sytë e me “Allahu ekber” na përcjellin nga kjo botë. Si të thuash, Vetë Zoti Mëshirëplotë, e ka bërë këtë Dëshmi, shoqëruesen tonë më të rëndësishme në jetë.

Fjala ‘minare’, është fjalë e madhe. Është emër simboli. Minare xhamie. Minare që buçet me lajmërimin më të shenjtë e madhështor në jetë. Minare që ndez drita udhëzimi e fton me simbolikën e saj për të bërë kthesë.

Minare, që bën me shenjë nga vetja, për secilin prej nesh, teksa çdo ditë lajmëron: “Hajje ales-salah / Hajje al-el-felah”, pra: “Eja në namaz / Eja në shpëtim”!

Sa paqe fal e sa dritë përhap, teksa çdo ditë që kalon, me hijeshinë e saj, në

heshtjen e pozitës së saj, flet pa harfe, duke dëshmuar: “Allahu ekber!”...

“Allahu ekber”, mbetet fjalëkalim me të cilin janë ndërtuar civilizime dhe është ndezur shpresa e humbur, kudo e përherë!

Me “Allahu ekber” hapim sytë e me “Allahu ekber” na përcjellin nga kjo botë. Si të thuash, Vetë Zoti Mëshirëplotë, e ka bërë këtë Dëshmi, shoqëruesen tonë më të rëndësishme në jetë.

E, nga këtu, çdo minare, kudo qoftë, mbetet simbol i shenjtë i më

madhështores Dëshmi, që shoqëron njeriun në çdo hap të jetës, duke i tërhequr vëmendjen se Vetë Zoti e ka bërë Mëkëmbës e, mëkëmbësve i shkon të jetojnë në shoqërinë e thirrjeve të minareve dritësuese!

Sot, u mbusha me frymë falënderimi, teksa pashë nga afër dy minaret më të reja të Shkodrës, që po marrin formën e tyre përfundimtare, në trupin e xhamisë së re të Tophanës.

Elhamdulillah për mirësinë e minareve në jetë!

Në kantier, më 8/4/2026



“RUAJU, MOS TË KAPI KJO LUTJE!”

Myftinia Shkodër, prej dekadash po përballet me padrejtësi të shumta në këtë drejtim, ku akoma qeveritë e këtij tranzicioni 36 vjeçar, nuk kanë arritur të sistemojnë katrahurën e padrejtësive dhe abizimit flagrant me çështjen e pronës.

Rast i patolerueshëm dhe shumë shqetësues për bashkësinë muslimane të Shkodrës, është grabitja spektakolare e vakëfit të Fushë Çelës në zemër të Shkodrës, ku prej kohësh kanë nisur punimet për një ndërtim, që paradoksalisht dhe jashtë çdo logjike drejtësie, vetë institucionet e konsiderojnë si arritje mbi arritjet!?

Ditën e hënë, më 27 prill 2026, nëpërmjet kanalit të tij në youtube, Imam Muhamed B. Sytari, Myfti i Zonës Shkodër, risolli në vëmendje një plagë të pambyllur akoma në shoqërinë shqiptare që është grabitja e pronës së tjetrit dhe vuajtjet e pronarëve legjitimë për të marrë hakun e tyre nëpërmjet certifikimit të pronës private që i jep mundësi edhe zhvillimit të saj.

Myftiu solli në vëmendjen rastin e sahabiut të nderuar, Hz. Said ibn Zejd (r.a), të cilin e akuzuan një ditë se kishte grabitur një tokë.

I gjendur përballë gjyqtarit, sahabi u nderuar u shpreh: “Të grabis unë një tokë, ndërkohë që kam dëgjuar atë fjalë të madhe nga i Dërguari i Allahut (a.s)!” Dhe kur gjyqtari e pyeti për hadithin në fjalë ai tha: I Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: “Ai që grabit, qoftë edhe një pëllëmbë tokë, ajo do t’i lidhet sa shatë fishi i tokës në qafën e tij në ditën e kiametit”, pra si shenjë ndëshkimi i madh nga Zoti i gjithësisë për këtë padrejtësi të madhe në hak të pronarit legjitim.

Myftiu tërhoqi vëmendjen se akoma sot, 36 vite pas rënies së komunizmit, në shoqërinë shqiptare fenomeni i vëllavrasjes, i ngatërresave dhe i përplasjeve shpesh edhe të dhunshme për shkak të pronësisë dhe grabitjes së pronës legjitime, është një plagë e cila e rëndon përherë e më shumë çështjen e sigurisë kombëtare, ekuilibrat e paqes sociale dhe cilësinë e vlerave qytetëruese që duhet të dëshmojnë në shoqërinë tonë.

Myftiu i bëri thirrje të gjithë atyre


që kanë shkelur në pronën e tjetrit, që kanë grabitur qoftë edhe një pëllëmbë tokë apo kanë falsifikuar certifikatat e pronësisë, këtu apo atje, që dera e pendimit është akoma e hapur dhe se çdo njeri sado i paudhë që të jetë e ka një moment kthese dhe reflektimi për t’u kthyer tek e drejta.

Njëkohësisht, Myftiu theksoi se prona legjitime është e shenjtë dhe se kushdo që përpiqet në këtë rrugëtim ka bekimet e Zotit dhe mbështetjen e Tij.

Këtë mesazh, Myftiu e lidhi edhe me lutjen që sahabi u nderuar, Said ibn Zejd bëri kundër personit që e kishte akuzuar padrejtësisht për grabitjen e pronës me ç’rast tha: “O Zoti im, nëse kjo grua që më akuzon është gënjeshtare verboja sytë dhe merrja shpirtin në tokën e saj”. Nuk kaloi shumë dhe ajo grua u verbua dhe një ditë teksa lëvizte në bahçen e saj ra në një gropë dhe vdiq. Ajo shpesh, pas verbimit, thoshte: “Më ka zënë dua e Said ibn Zejdit!”.

Myftinia Shkodër, prej dekadash po përballet me padrejtësi të shumta në këtë drejtim, ku akoma qeveritë e këtij tranzicioni 36 vjeçar, nuk kanë arritur të sistemojnë katrahurën e padrejtësive dhe abizimit flagrant me çështjen e pronës.

Rast i patolerueshëm dhe shumë shqetësues për bashkësinë muslimane të Shkodrës, është grabitja spektakolare e vakëfit të Fushë Çelës në zemër të Shkodrës, ku prej kohësh kanë nisur punimet për një ndërtim, që paradoksalisht dhe jashtë çdo logjike drejtësie, vetë institucionet e konsiderojnë si arritje mbi arritjet!?



SHEJKH MUHAMED EL-GAZALI
(1917 - 1996)

“**Është sqaruar e vërteta nga e kota”, pas kësaj njerëzit janë të lirë...**

“Ne jemi pjesëtarë të fesë, që ka ardhur në librin e saj të parë: **“Me të drejtë (me hak) e kemi zbritur dhe me të drejtë (me hak) ka zbritur”.**

Ne nuk frikësohemi nga drita; ne urrejmë errësirën dhe urrejmë zullumin.

Ne duam mjedis të lirë, sepse mjedisi i lirë, ai është i cili na lejon të shpalojm fenë tonë dhe atë ditë, që shpalojm fenë tonë në mjedis të lirë, ne jemi të bindur se paraqitja e shëndoshë do të japë rezultatin e saktë;

Dhe, se ato të vërteta që kemi, mendja njerëzore i pëlqen dhe natyra e drejtë është e kënaqur me to, me kusht që ne të vazhdojmë përpara pa u frikësuar.

Feja jonë krenohet, se ajo është fe e mendjes dhe se ajo ua shpalojë njerëzve të vërtetën dhe thotë: **“Është sqaruar e vërteta nga e kota”,** pas kësaj njerëzit janë të lirë...

Gjatë studimeve të mia të të gjitha feve dhe të të gjitha filozofive nuk kam njohur fe, që të punojë në liri, edhe nëse liria është kundër saj, si kjo fe, të cilës ne i përkasim!





Sheikh Muhamed El-Gazali
(1917 - 1996)

FITNEJA PËRBRENDA ËSHTË MË E DËMSHME PËR YMETIN SE SA SULMET E DUKSHME NGA JASHTË*

Nuk kam aspak dyshim, se pas këtyre tipave të tillë mendjelehtë të papjekur është një plan i pistë, që kërkon copëtimin e trupit islam dhe krijimin e vesveseve për tipa të tillë, se librat bashkëkohorë janë të pavlerë, dhe se shkrimet e vjetra të Ibn Tejmijes dhe Ibnul-Kajimit, vetëm ato janë prej të cilëve mund të merret Islami!

Një student nga qyteti i Zegazigut më vjen dhe më thotë: Disa persona deklarojnë se i përkasin selefizmit – por në realiteti nuk janë selefi – i kanë gjuajtur librat bashkëkohorë dhe nuk kanë pranuar që të prezantohen në panairin e librit islam. Librat bashkëkohorë, disa prej tyre janë të shkruar nga Prof. Sejid Kutub, Prof. Muhamed Kutub, Prof. Ebul-Hasen En-Nedeviu, Prof. Ebul-E'ala El-Mevdudi, Prof. Abdulkadir Avde, e shumë të tjerë.

I thashë: Nuk kam aspak dyshim, se pas këtyre tipave të tillë mendjelehtë të papjekur është një plan i pistë, që kërkon copëtimin e trupit islam dhe krijimin e vesveseve për tipa të tillë, se librat bashkëkohorë janë të pavlerë, dhe se shkrimet e vjetra të Ibn Tejmijes dhe Ibnul-Kajimit, vetëm ato janë prej të cilëve mund të merret Islami.

Shejkul-Islam, Ibn Tejmije është njeri i madh, edhe nxënësi i tij, Ibnul-Kajim është njeri i madh, e habitshmja është se Ibn Tejmije është sprovuar në kohën e tij me njerëz të tillë, që kanë folur për Imamët e Mëdhenj me një gjuhë të ashpër dhe kanë nëpërkëmbur nderin e tyre, dhe janë përpjekur të godasin majat (korifenjtë) e trashëgimisë islame dhe fukahatë (dijetarët islamë) madhështorë, kështu që Shejkul-Islam, Ibn Tejmije shkroi librin e tij me famë: “Ref’ul-melam an eimmetil-e’alam” (Shfajësimi i dijetarëve të mëdhenj).

E vërteta është, se ata të cilët shfaqen

me entuziazëm ndaj Ibn Tejmijes dhe Ibnul-Kajimit, janë xhahilë (injorantë), sepse Islami nuk ka qenë steril përpara lindjes së Ibn Tejmijes dhe Ibnul-Kajimit në shekullin e 7-të hixhri; shtatë shekuj përpara lindjes së Ibn Tejmijes dhe Ibnul-Kajimit dhe shtatë shekuj pas lindjes së Ibnul-Kajimit dhe Shejkhu të tij, Ibn Tejmijes janë të mbushur plot me burra të Islamit prej njerëzve me mendje të mprehta dhe zemra të gjalla e të zjarrta, ndjenjat e të cilëve ishte drejtuar nga Zoti dhe Pejgamberi i tyre.

Patjetër duhet, që në kohën tonë sot, të lexojmë librat bashkëkohorë, sepse pushtimi kolonialist, i cili ka sulmuar me kthetrat e tij botën islam në kohën tonë, i ri në metodat e tij, i pajisur me plane të panjohura për vjedhjen e parimeve të besimit dhe nënvlerësimin e vlerave të larta, dhe ai tërheq nga pas një sfond të madh prej qytetërimit perëndimor, i cili ka lulëzuar në fushën e shkencës dhe zbatimit, ia ka arritur të shfrytëzojë neglizhencën tonë, mungesë e vëmendjes dhe plogështinë tonë në shërbim të fesë përgjatë shekujve të fundit, e na ka sulmuar me sulme të llojllojshme, që kanë nevojë për ide (mendime) të reja, ashtu siç ka thënë Omer ibn Abdulazizi (r.h), në shekullin e 2-të: “Lindin çështje të reja për njerëzit, aq sa shpikin edhe mëkate (të reja)!”

Atëherë, si mund të thuhet: Kultura islame ka përfunduar me shkrimet (librat) e Ibn Tejmijes dhe Ibnul-Kajimit?! Unë jam prej atyre, të cilët janë formësuar prej Ibn Tejmijes, Ibnul-

Kajimit, Ibn Ruzhdit, El-Gazaliut, Ibnul-Xheviziut, Ibn Hazmit dhe natyrisht nxënësi i vogël i Katër Imamëve të Mëdhenj, të cilët kanë arritur majat në trashëgiminë tonë mendore dhe fikhere, dhe që konsiderohen shembuj të lartë në përkushtimin ndaj Allahut dhe dobinë ndaj njerëzve.

Nuk kam aspak dyshim, se ata të cilët mbajnë fanatizëm për filanin dhe filanin prej imamëve dhe dijetarëve dhe që duan të copëtojnë bashkësinë tonë me të tilla ide (mendime), nuk kam aspak dyshim, se pas këtij ekstremizmi ka duar të pista prej sionizmit dhe kryqëzatave, prej atyre që punojnë për llogari të kolonizimit globalist.

Fitneja përbrenda është më e dëmshme për ymetin se sa sulmet e dukshme nga jashtë. Dhe, për këtë arsye myslimanët e kohës tonë sot duhet të shikojnë me shqetësim grindjet e tepruara, të cilat përhapen tani, sepse është shumë e habitshme që jehuditë të hynë në sinagogat e tyre dhe zemrat të takohen për të na shqyer dhe për të na sulmuar, e të dalin myslimanët prej xhamive në rreshta të copëtuar me mendime të cekëta dhe çështje të ulëta.

Këto rreshta janë jashtë temës, gjë të cilën u detyrova të bëj, ndërkohë që unë në të vërtetë dua të hedh vështrimin nga sureja El-Ahزاب.

*- Titulli është i përkthyesit

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:
Lavdrim Hamja



Arben Halluni, teolog

Feja e lashtë indiane kthehet në kohë shumë të hershme, që nga epokat më të vjetra për të cilat janë regjistruar ngjarje në librat e lashtë indianë. Studiuesit ndryshojnë në përcaktimin e kohës së lindjes së saj; disa e çojnë atë në mijëra vite para erës sonë, ndërsa të tjerë në periudha më të afërta. Megjithatë, ka një pajtim të përgjithshëm se kjo fé është ndër më të vjetrat në histori.

Mendohet se feja e vjetër indiane është një përzierje e besimeve të fiseve të ndryshme, të cilat kanë hyrë në Indi në kohë të ndryshme para lindjes së Isait (a.s). Këto fise u vendosën në rajonin ndërmjet Indisë dhe luginës së Eufratit, dhe më pas u shpërndanë në drejtime të ndryshme, duke përhapur ndikimin e tyre në Azi dhe më gjerë.

Një pjesë e studiuesve besojnë se kjo fé nuk është e pastër, por ka marrë ndikime nga qytetërimet e tjera si ai babilonas dhe egjiptian, duke qenë se India ndodhej në një pikë ndërmjet këtyre kulturave të mëdha.

Besimet dhe hyjnitë në fenë indiane Feja e vjetër indiane përfshinte forma të ndryshme adhurimi. Ajo njihje forca të natyrës si hyjni: shiun, erën, detin, zjarrin dhe dritën. Për shembull, shiu konsiderohej një hyjni dhe quhej “Indra”, nga i cili kërkohej ndihmë në kohë nevojë.

Gjithashtu, fjala “Deva” (zot) ka lënë gjurmë në shumë gjuhë evropiane, si në frëngjisht “Dieu” dhe në anglisht “Deity”. Kjo tregon ndikimin e hershëm të mendimit indian në gjuhë dhe kulturë të tjera.

Në këtë fé, hyjnia shpesh përshkruhej si “ati dhurues”, një koncept që ka kaluar në shumë gjuhë dhe besime.

Adhurimi i natyrës dhe i paraardhësve Në Indinë e lashtë përhapet adhurimi

FEJA NË INDI DHE DEVIJIMET E SAJ NË BESIM

Detyra e besimtarit është të ruajë akiden e pastër, të pastrojë besimin nga çdo formë shirkut, qoftë ajo e hapur apo e fshehtë, dhe të mbështetet vetëm në Allahun e Madhëruar në çdo aspekt të jetës.

Teuhidi nuk është vetëm një bindje teorike, por është themeli mbi të cilin ndërtohet shpëtimi i njeriut në këtë botë dhe në botën tjetër...

i dukurive natyrore dhe i paraardhësve. Mbretërit dhe udhëheqësit shpesh konsideroheshin të shenjtë dhe adhurimi i tyre ishte vazhdim i adhurimit të kryeplakut të fisit.

Ceremonitë dhe ritualet shpesh lidheshin me mite për krijimin e botës. Në disa tregime, jeta thuhej se kishte dalë nga një “vezë e artë”, ndërsa në të tjera përmendej një krijues mashkull dhe femër si burim i jetës.

Devijimi drejt politeizmit dhe besimeve të gabuara

Me kalimin e kohës, besimi në një Zot të vetëm u zbeh dhe u përzien me forma të ndryshme shirkut. U përhapën ide si:

- Uniteti i ekzistencës (vahdetul-vuxhud) në kuptim të shtrembëruar
 - Rimishërimi (transmigrimi i shpirtit)
 - Adhurimi i kafshëve dhe i objekteve
- Njerëzit filluan të besonin se shpirti kalon nga një trup në tjetrin, madje edhe në kafshë, dhe se kjo është pjesë e një cikli të pafund.

Koncepti i karmës dhe cikli i jetës

Një nga shtyllat e këtyre besimeve është ideja e “Karma”-s, sipas së cilës çdo veprim ka pasojat e veta dhe përcakton fatin e njeriut në jetët e ardhshme.

Sipas këtij koncepti, jeta është një cikël i pafund lindjesh dhe vdekjesh, ku njeriu vazhdimisht rikthehet në forma të ndryshme, derisa të arrijë një lloj çlirimi.

Besimet filozofike dhe pyetjet mbi krijimin

Disa tekste të vjetra indiane përshkruajnë gjendjen para krijimit me fjalë që shprehin paqartësi dhe hutim:

Nuk kishte as ekzistencë dhe as mos-ekzistencë,

nuk kishte qiell e as tokë,

dhe nuk dihej kush e krijoi gjithësinë.

Këto përshkrime tregojnë mungesën e një besimi të qartë dhe të qëndrueshëm mbi Krijuesin.

Budizmi dhe zhvillimet e mëvonshme

Më vonë u shfaq budizmi, i cili ndërtoi filozofinë e tij mbi vuajtjen dhe çlirimin prej saj. Ai përmbledh jetën në katër të vërteta kryesore:

1. Jeta është vuajtje
2. Vuajtja ka një shkak
3. Vuajtja mund të zhduket
4. Ekziston një rrugë për ta arritur këtë

Megjithatë, edhe këto mësimet mbeten më shumë filozofike sesa një besim i pastër monoteist.

Përfundim

Nga këndvështrimi i akides islame, këto besime përfaqësojnë një devijim nga teuhidi i pastër. Ato përziejnë të vërtetën me të pavërtetën, duke larguar njeriun nga besimi i drejtë në një Zot të vetëm, Krijues dhe Sundues i gjithësisë.

“Dhe Zoti juaj është një Zot i vetëm, nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Tij, Mëshiruesi, Mëshirëploti.” - (Suretu El-Bekare, 163)

I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: “E drejta më e madhe e Allahut mbi robërit është që ta adhurojnë Atë dhe të mos i bëjnë shok asgjë.” - (Buhariu dhe Muslimi)

Këto bëjnë të qartë se themeli i besimit është njësimi i Allahut (teuhidi), dhe çdo devijim nga ky parim është rrëshqitje në shirk.

Prandaj, detyra e besimtarit është të ruajë akiden e pastër, të pastrojë besimin nga çdo formë shirkut, qoftë ajo e hapur apo e fshehtë, dhe të mbështetet vetëm në Allahun e Madhëruar në çdo aspekt të jetës.

Teuhidi nuk është vetëm një bindje teorike, por është themeli mbi të cilin ndërtohet shpëtimi i njeriut në këtë botë dhe në botën tjetër...

(Vazhdon në numrin e ardhshëm)



Naim Drijaj

Imam - Xhamia Parrucë

Mësimet që morëm nga Ramazani duhet t'i jetësojmë. Në këtë hytbe dua të përmend disa udhëzime praktike se si të vazhdojmë t'i përgjigjemi kërkesave të Zotit të Madhëruar edhe pas Ramazanit.

Në Ramazan agjëruam, braktisëm ushqimin dhe pijet gjatë një kohe të caktuar, për një muaj të tërë. Krahas kësaj, rritëm intensitetin e adhurimeve dhe përkushtimin ndaj Zotit. Pse ndodhi e gjithë kjo? Sepse besimi ynë ishte funksional, e aktivizua atë dhe iu përgjigjem thirrjes së Allahut: "O ju që keni besuar, agjërimi u është bërë obligim".¹

1. Të vazhdojmë ta mbajmë besimin tonë të gjallë dhe aktiv, ashtu siç e mbajtëm gjatë Ramazanit, dhe t'i përgjigjemi thirrjeve të Zotit të Madhëruar në çdo kohë, ashtu siç iu përgjigjem thirrjes për agjërim. Me të njëjtën thirrje "O ju që keni besuar", Allahu (xh.sh) na thërret:

Të falim namazin, të largohemi nga paragjykimet dhe të verifikojmë lajmet që na vijnë.

Të trajtojmë dhe të konsiderojmë njëri-tjetrin si vëllazër.

Të mos përqeshim, të mos ofendojmë, të mos nënçmojmë dhe të mos përbuzim njëri-tjetrin.

Të ndihmojmë njëri-tjetrin.

Nëse i jemi përgjigjur thirrjes: "O ju që keni besuar, agjërimi", njëta thirrje e besimit na fton që të vazhdojmë t'i përgjigjemi të gjitha thirrjeve të Zotit, ashtu siç iu përgjigjem thirrjes për agjërim. Prandaj, edhe pas Ramazanit, le të mbajmë besimin tonë të gjallë

1. Kur'ani, El-Bekare: 183.

SI TË VAZHDOJMË PAS RAMAZANIT?

dhe aktiv, le të mos e lëmë të zbehët dhe të plogështohet. Të vazhdojmë ta ushqejmë me vepra të mira, me adhurim, me mirësi ndaj të tjerëve dhe me përkushtim ndaj Zotit, që besimi ynë të mbetet i fuqishëm dhe funksional gjatë gjithë vitit.

2. Të vazhdojmë të jemi të kujdesshëm, ashtu sikur në Ramazan. Në Ramazan treguam kujdes që asnjë pikë ujë të mos kalojë në fyt, po të njëjtin kujdes duhet të tregojmë edhe pas Ramazanit. Të kemi kujdes për fjalët që themi, të kemi kujdes se si e fitojmë pasurinë dhe ku e shpenzojmë atë, të kujdesemi me kë shoqërohemi dhe si të veprojmë në çdo aspekt të jetës.

Umer ibn Hatabi (r.a) e pyeti Ubejin (r.a) për devotshmërinë, ndërsa ai iu përgjigj duke i thënë: - "A ke ecur ndonjëherë nëpër rrugë me gjemba (ferra)?" - "Po".- u përgjigj ai. -"Atëherë, si ke vepruar?" - pyeti Ubeji. - "Kam bërë shumë kujdes iu përgjigj ai. Atëherë Ubeji (r.a) tha: "Kjo pra është devotshmëria."²

3. Ta vazhdojmë atë afrimet që patëm gjatë Ramazanit. Iftaret, syfyret dhe namazet na bashkuan dhe na dhanë mundësinë të afrohem me shumë me njëri-tjetrin.

Ky bashkim duhet të vazhdojë edhe pas Ramazanit. Kështu Ramazani na mësoi që kemi mundësi që të jemi të bashkuar dhe nëse jemi bashkë, çdo gjë është më e lehtë dhe më e bukur.

Dikush mund të pyesë: "E kuptuam që duhet të vazhdojmë me këto punë të mira dhe shumë të tjera, por pyetja është: Si të vazhdojmë?"

1. Duke kërkuar ndihmë prej Allahut. Asnjë punë nuk mund ta bëjmë pa ndihmën dhe suksesin e Zotit të Madhëruar. Vazhdimisht, Allahu (xh.sh) edhe kur jemi në namaz dhe të kthyer nga Ai, na kërkon që të lutemi: "Udhëzoni në rrugën e drejtë"³, "Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë".⁴ Prandaj, gjithmonë duhet të kërkojmë ndihmë prej Allahut, që të jemi të vazhdueshëm në besim, në adhurim dhe në vepra të mira.

2. Tefsir El-Kurtubij, 1/161.

3. Kur'ani, El-Fatiha: 6.

4. Kur'ani, El-Fatiha: 5.

E kanë pyetur bashkëshorten e Pejgamberit (a.s), Umu Selemen (r.anha) se cila ishte lutja më e shpeshtë e Pejgamberit (a.s). Ajo u përgjigj se lutja më e shpeshtë e tij (a.s) ishte: "O Ti që në dorën Tënde janë zemrat e njerëzve, ma forco zemrën time në fenë Tënde!"⁵

2. Të vazhdojmë me falënderim, ashtu siç vazhdojmë të shfrytëzojmë begatitë e Allahut. Falënderimi ndaj Allahut duhet të jetë i vazhdueshëm, në çdo çast të jetës sonë, duke na bërë të vetëdijshëm për dhuntitë që Ai na ka dhënë dhe duke na udhëzuar që t'i përdorim ato në mënyrë të drejtë dhe të dobishme.

3. Të vazhdojmë t'ia kujtojmë vetes se misioni nuk ka përfunduar. Agjërimi dhe Ramazani ishin një stacion i këtij misioni, një mundësi për të forcuar lidhjet me Allahun, por nuk janë fundi i misionit tonë. Puna jonë për të qenë besimtarë të përkushtuar dhe për të bërë vepra të mira vazhdon gjatë gjithë vitit.

Në Betejën e Uhudit u përhap lajmi se Pejgamberi (a.s) kishte vdekur. (Në të vërtetë, Pejgamberi (a.s) nuk kishte vdekur; lajmi ishte përhapur për të dobësuar muslimanët). Disa nga sahabët u dëshpëruan nga ky lajm, u ndalën dhe nuk vazhduan drejt betejës. Një nga shokët e Profetit (a.s), i cili nuk e pa situatën si ata, u tha: "Pse nuk luftoni? Beteja nuk ka përfunduar." Kur i thanë se Pejgamberi (a.s) ka vdekur, ky sahabi u përgjigj: "Nëse Pejgamberi (a.s) ka vdekur, vazhdoni rrugën që ai ndoqi deri në vdekje, që edhe ju të vdisni duke ndjekur atë rrugë!"

Misioni ynë nuk përfundon me një stacion të përkohshëm; ai vazhdon deri në vdekje, ashtu si na mëson Allahu (xh.sh): "Adhuroje Zotin tënd, derisa të vijë vdekja!"⁶

O besimtarë, sikur ta jetojmë jetën si në Ramazan, bota tjetër për ne do ishte Bajram!

Parrucë, më 3.4.2026

5. Transmeton Tirmidhiu.

6. Kur'ani, El-Hixhr: 99.

KRYETARI I KOMUNITETIT MUSLIMAN SHQIPTAR NË ZVICËR VIZITOI SHKODRËN

Ditën e mërkurë, më 15 prill 2026, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari priti në një takim të përzemërt e vëllazëror, Kryetarin e Komunitetit Musliman Shqiptar në Zvicër, Hfz. Mehas ef. Alija, që shoqërohej në këtë vizitë nga nënkryetari i parë i KMSHz-së, Mr. Fehim ef. Abazi dhe nënkryetari i dytë i KMSHz-së, Dr. Besim ef. Nuzi.

Gjatë takimit të përzemërt, Myftiu i Shkodrës shprehu kënaqësinë e tij për vizitën e shumëpritur të vëllazërve të tij të dashur, Kryetarit të KMSHz-së dhe dy nënkryetarëve të këtij institucioni, që mbledh nën ombrellën e tij mbi 80 qendra islame shqiptare në Zvicër.

Gjatë bashkëbisedimit vëllazëror u diskutua rreth angazhimeve dhe shërbimeve me dobi që hoxhallarët e nderuar shqiptarë kryejnë sot në shtetin helvet, duke u bërë ambasadorët më të mirë të Islamit dhe të trashëgimisë sonë të pasur kombëtare.



Myftiu Sytari:

KONTRIBUTI I HOXHALLARËVE SHQIPTARË NË ZVICËR PO RRIET DHE KONSOLIDOHET DITË PAS DITE, DUKE U KTHYER NË NJË PIKË REFERIMI EDHE PËR AUTORITETET VENDASE, QË SHOHIN NË BASHKËPUNIMIN DHE SHEMBULLIN E DREJTUESVE TË LARTË DHE IMAMËVE TË KMSHz-SË, PRIJËSIT E URTË DHE LARGPAMËS QË KONTRIBUOJNË PËR TË MIRËN E KOMUNITETIT DHE NDËRTIMIN E URAVE TË DIALOGUT NDËRFETAR DHE JO VETËM NË MESIN E PJESTARËVE TË SHOQËRISË ZVICERANE.



Në një mesazh përpara mediave të pranishme, Myftiu Sytari theksoi se kontributi i hoxhallarëve shqiptarë në Zvicër po rritet dhe konsolidohet ditë pas dite, duke u kthyer në një pikë referimi edhe për autoritetet vendase, që shohin në bashkëpunimin dhe shembullin e drejtuesve të lartë dhe imamëve të KMSHz-së, prijësit e urtë dhe largpamës që kontribuojnë për të mirën e komunitetit dhe ndërtimin e urave të dialogut ndërfetar dhe jo vetëm në mesin e pjestarëve të shoqërisë zvicerane.

Nga ana e tij, Kryetari i KMSHz-së dhe dy nënkryetarët e tij, falënderuan

Myftiun e Shkodrës për mikpritjen dhe shprehën kënaqësinë e tyre për këtë vizitë të dashur në qytetin e Shkodrës.

Më pas, bashkëbisedimi vijoi me diskutimin e një sërë tematikash me interes të përbashkët.

Drejtuesit e lartë të KMSHz-së, të shoqëruar nga Myftiu i Shkodrës, zhvilluan një vizitë edhe në Medresenë "Haxhi Sheh Shamia", ku u pritën nga z. Kujtim Dervishi dhe z. Nexhmi Spahia, drejtori i ri i Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", të cilët informuan miqtë e dashur me historikun e Medresesë së Shkodrës dhe gjurmët e shënuara të

këtij institucioni arsimor me vlerë dhe peshë kombëtare gjatë 35 viteve të aktivitetit, pas ringritjes në vitin 1991.

Pjesë e kësaj vizite ishte edhe falja e namazit të iqindisë në xhaminë e Plumbit, ku vizitorët e dashur panë nga afër kompleksin e ri të xhamisë shekullore të qytetit të Shkodrës, dhe dëgjuan me kënaqësi informacionet rreth historikut të kësaj xhamie të lashtë, e cila ka hapur dyert prej rreth një viti, pas rikonstruksionit të shumëpritur që i dha këtë pamje të mrekullueshme dhe të shumëpritur për të gjithë besimtarët dhe vizitorët e shumtë të saj.

MESAZHE DHE KËSHILLA ME VLERË NGA DREJTUES TË LARTË TË KMSHZ-SË, PËR IMAMËT E SHKODRËS



Pasditen e së mërkurës, më 15 prill 2026, Myftinia Shkodër organizoi një tryezë intelektuale, ku ishin të ftuar, Kryetari i Komunitetit Musliman Shqiptar në Zvicër, Hfz. Mehas ef. Alija dhe dy nënkryetarët e këtij institucioni, Mr. Fehim ef. Abazi dhe Dr. Besim ef. Nuzi.

Në krye të herës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari shprehu kënaqësinë e tij për organizimin e kësaj tryeze vëllazërore nëpërmjet të cilës imamët e Shkodrës kanë mundësinë të dëgjojnë nga urtësia dhe eksperiencat e drejtuesve më të lartë të Komunitetit Musliman Shqiptar në Zvicër, eksperiencat që përkthejnë më së miri kontributin e madh dhe shërbimet e vazhdueshme të vëllazërve të shtrenjtë në Zvicër, në aktivitetin e tyre shumëvjeçar, në ruajtje të trashëgimisë islame dhe traditave më të mira shqiptare të trashëguara nga të parët.

Në mesazhin e tij për imamët e pranishëm, Kryetari i KMSHZ-së, Hfz. Mehas ef. Alija, pasi shprehu falënderimet e thella për Myftininë Shkodër, për këtë organizim shumë domethënës, shprehu kënaqësinë e tij për këtë takim të përzemërt me imamët e Myftinisë Shkodër, të cilëve iu drejtua me disa këshilla dhe fjalë zemre, që përkthejnë më së miri rolin e rëndësishëm që ka imami në edukimin e brezave dhe ruajtjen e ekuilibrave të harmonisë dhe vëllazërisë islame në mesin e besimtarëve.

Një fjalë me shumë rëndësi ishte edhe ajo e mbajtur nga nënkryetari i parë i KMSHZ-së, Mr. Fehim ef. Abazi, i cili iu drejtua të pranishmëve me disa mesazhe plot dobi, duke tërhequr vëmendjen drejt rëndësisë që ka bashkëpunimi dhe ruajtja e frymës së vëllazërisë për

përhapjen me urtësi dhe largpamësi të mesazhit islam në mesin e besimtarëve, dhe ndërtimin e urave qytetërore me çdo pjestar të komunitetit dhe shoqërisë ku jetojmë.

Ndërkohë, nënkryetari i dytë i KMSHZ-së, Dr. Besim ef. Nuzi, vuri theksin tek rëndësia që ka ndjenja e përgjegjësisë që imami duhet të ketë në shërbimet e tij për komunitetin, duke e konsideruar veten e tij si të ngarkuar para Zotit dhe para besimtarëve, si një njeri elitar që respekton peshën e misionit dhe amanetin që mban mbi supet, dhe që di të vlerësojë çdo moment të ditës dhe të natës për t'i shërbyer komunitetit pa asnjë rezervë.

Aktiviteti vazhdoi me ndërhyrjet dhe mesazhet plot dobi, nga Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, nga H. Bashkim Bajraktari, nga teologu Artur Tagani dhe z. Kujtim Dervishi, në mesazhet e të cilëve kishte një tërheqje vëmendjeje drejt rëndësisë që kanë këto tubime, si dhe vlerësimit të kohës për të dëshmuar përherë e më shumë vlerat e Thirrjes Islame dhe ruajtjen e trashëgimisë shekullore dhe tabanit të baballarëve, si amanete të shtrenjta që duhen ruajtur me shumë përkushtim.

Gjatë këtij aktiviteti me vlerë u përmend edhe roli i hoxhallarëve të shkuar elitarë të qytetit të Shkodrës, si dhe domosdoshmëria e ruajtjes së asaj fryme qytetërore, të cilën e mbollën tek nxënësit e tyre dhe tek shoqëria, në mënyrë që stafeta qytetërore që hoxhallarët i përcjellin njëri-tjetrit të trashëgohet me dinjitet dhe të njohë përherë rritje në kurbën e aktivitetit plot përkushtim të prijësve të urtë fetarë muslimanë në qytetin e Shkodrës, në mbarë trojet shqiptare dhe kudo që ata veprojnë dhe shërbejnë.



Pejgamberi (a.s) ka thënë:



*Allahumme
më sjell dobi
nga ajo që
më ke mësuar
dhe më mëso nga ajo
që më sjell dobi, ma
shto diturinë!
Falënderimi
i takon Allahut
për çdo gjendje
dhe kërkoj mbrojtjen
e Allahut nga
gjendja e banorëve
të zjarrit!”*

(Transmeton Tirmidhiu
dhe Ibn Maxheh, nga Ebu Hurejra)



Nëpërmjet dërsit të xhamisë, që mbajti në xhaminë e Plumbit, më 3 prill 2026, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, hodhi dritë rreth kuptimeve të ajetit 10 të sures El-Huxhuratë, ku udhëzohemi: “S’ka dyshim se besimtarët janë vëllazër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllazërve tuaj dhe kini frikë Allahun, që të jeni të mëshiruar (nga Zoti).”

Myftiu theksoi se është detyrë e çdo muslimani, të mos gjurmojë në gabimet dhe të metat e tjetrit, por ta vendosë interesin e vëllazërisë së shenjtë islame, mbi çdo interes tjetër!

Ai nxiti njëkohësisht respektimin e prijësve fetarë, myftilerëve, hoxhallarëve, imamëve, hatibëve, vaizëve e muezinëve, ku tërhoqi vëmendjen e besimtarëve: “Njerëzit e dijës e të besimit, janë njerëz të nderuar e të respektuar. Mos i poshtëroni! Mos të bëhet lavdi në mesin tonë se kemi shkruar kundër hoxhës, kundër imamit e kundër Myftiut! Mos të mburremi me ‘like’ të shejtanit, se kemi hedhur baltë mbi institucionin tonë, mbi Myftiun tonë, mbi imamin tonë, mbi hatibin tonë e mbi muezinin tonë! Mos të bëhemi ne, të gjithë ne pa përjashtim, taborra të shejtanit, që

MYFTIU: “KËSHILLAT E PAJTIMTARËVE DUHET TË JENË VIGJILENTË NË ÇDO XHAMI!”



duartrokot sa herë që muslimanët janë në llogore kundër njëri-tjetrit! Edhe për çfarë xhanëm, për çfarë? Për banalitete? Për të triumfuar nefs i gjithsecilit!”

Myftiu Sytari përmendi edhe takimin me imamët e Myftinisë Shkodër, ku u vendos krijimi i Këshillit të Pajtimtarëve për çdo xhami në qytet e fshat!

“Në rast se ne e vërtetojmë se në

mesin e xhematit tonë ka njerëz që nuk komunikojnë dhe nuk shkojnë me njëri-tjetrin, duhet me doemos të ndërhyjmë, t’i ulim e t’i pajtojmë! Absolutisht! Mos t’i lëmë të dalin nga xhamia, veçse dorë për dorë!”

Myftiu solli shembuj të shumtë nga trashëgimia e brezave të shkuar dhe këshillat e tyre për ruajtjen dhe forcimin e vëllazërisë së shenjtë islame.

MYFTIU INSPEKTOI PUNIMET PËR XHAMINË E RE TË TOPHANËS

Ditën e mërkurë, më 8 prill 2026, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i shoqëruar nga administratori i Myftinisë Shkodër, z. Saimir Dritareti dhe menaxheri i vakëfeve pranë Myftinisë Shkodër, z. Blendi Alushi, zhvilloi një inspektim për të parë nga afër ecurinë e punimeve në kantierin e xhamisë së re në lagjen Tophanë.

Gjatë këtij inspektimi, Myftiu dhe stafi i tij, panë nga afër punimet thuajse të përfunduara të sallës kryesore të faljes, ato të sallës së faljes për motrat muslimane, dhomën e imamit dhe



ambientet shtesë në funksion të këtij projekti të ri, që Myftinia Shkodër po realizon në bashkëpunim me shoqatën “Qatar Charity”.

Myftinia Shkodër falënderon përkushtimin e gjithë të angazhuarve për realizimin me sukses të këtij projekti mëse të domosdoshëm për lagjen Tophanë, si dhe shpreson që bashkëpunimi me “Qatar Charity” të vazhdojë edhe me projekte të tjera të dobishme në qytetin e Shkodrës.

BOSNJE-HERCEGOVINA OSE BOSNJA

Bosnje-Hercegovina, ose shkurt Bosnja, është një vend në Evropën Lindore, në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik, dhe kufizohet me Serbinë në lindje, me Malin e Zi në juglindje, me Kroacinë në veri dhe jugperëndim, siç ka edhe një vijë bregdetare 20 kilometra të gjatë në Detin Adriatik, në jug.

Në vitin 1995, me Marrëveshjet e Dejtonit, brenda këtij vendi u krijua edhe Republika Srpska (Republika Serbe e Bosnjës) e vendosur në veri dhe lindje të territorit të Bosnje-Hercegovinës, ndërkohë që Federata e Bosnje-Hercegovinës shtrihet në zonat perëndimore dhe qendrore.

Kryeqyteti i vendit është **Sarajeva**, kurse qytete të tjera të rëndësishme janë Mostari, Banja Luka, etj.

Vendi ka një sipërfaqe prej 51,209 km² dhe një popullsi prej 3,133,093 (Tetor 2025, sipas worldometers.info).

GJEOGRAFIA

Bosnje-Hercegovina ka një terren kryesisht malor. Alpet Dinarike dominojnë kufirin perëndimor me Kroacinë. Vargmale të shumta që përfshijnë Kozarën, Vlashiçin, Pljeshevicën, Grmeçin, Cincarin dhe Radushën, e përshkojnë vendin përgjithësisht në drejtimin veriperëndim-juglindje. Maja më e lartë është maja Magliç (2386 m), pranë kufirit me Malin e Zi.

Në jug dhe jugperëndim të vendit gjendet rajoni Karst, me pllaja gëlqerore të thata që përmbajnë shpella, gropa dhe ujëra nëntokësore. Malësitë atje shpesh janë të zhveshura (si rezultat i shpyllëzimit dhe tokave me shtresa të holla të dheut në sipërfaqe), por ultësirat midis kreshtave janë të mbuluara me tokë aluviale që është e përshtatshme për bujqësi. Lartësitë prej më shumë se 1800 metrash janë të zakonshme dhe pllajat zbresin në mënyrë të menjëhershme drejt detit Adriatik.

Vija bregdetare, e kufizuar në një gjatësi prej 20 km përgjatë detit Adriatik, kufizohet nga të dyja anët nga Kroacia dhe nuk përmban porte natyrore.

Në Bosnjën qendrore, shkëmbinjtë dhe tokat janë më pak të ndjeshme ndaj erozionit, dhe terreni atje karakterizohet nga pllaja të ashpra, por të gjelbra dhe shpesh të pyllëzuara. Në veri, përgjatë lumit Sava dhe degëve të tij, shtrihen

ultësira të ngushta.

Lumenjtë kryesorë në vend janë: lumi Sava, që është një degë e Danubit dhe që formon kufirin verior me Kroacinë; lumenjtë Bosna, Vrbas dhe Una, të cilët burojnë në veri dhe derdhen në Sava; Drina, i cili rrjedh në veri dhe formon pjesë të kufirit lindor me Serbinë, dhe që është gjithashtu një degë e Savës; lumi Neretva, i cili buron nga juglindja, por merr një rrjedhë të mprehtë jugperëndimore përmes Kroacisë dhe derdhet në detin Adriatik. Lumenjtë në Karst rrjedhin kryesisht në tokë. Liqene të shumta akullnajore

i ftohtë është janari, me një temperaturë mesatare prej rreth 0 °C, dhe muaji më i ngrohtë është korriku, temperatura mesatare e të cilit është rreth 22 °C. Gjatë janarit dhe shkurtit Banja Luka merr sasinë më të vogël të reshjeve, kurse në maj dhe qershor përjeton reshjet më të dendura.

Hercegovina ka më shumë ngjasim me rajonin kroat të Dalmacisë, i cili mund të jetë jashtëzakonisht i nxehtë në verë. Në Mostar, i vendosur përgjatë lumit Neretva, muaji më i ftohtë është janari, me temperaturë mesatare rreth 6 °C, dhe muaji më i ngrohtë është korriku, me temperaturë mesatare rreth 26 °C.



shpërndahen nëpër peizazhin e vendit. Bosnje-Hercegovina është gjithashtu e pasur me burime natyrore, shumë prej të cilave shfrytëzohen për ujë mineral të ambalazhuar, ose për SPA (Ilixha) termike shëndetësore.

KLIMA

Edhe pse e vendosur pranë detit Mesdhe, Bosnje-Hercegovina është kryesisht e izoluar nga ndikimi i tij klimatik për shkak të Alpeve Dinarike. Moti në rajonin e Bosnjës i ngjan atij të malësive jugore austriake - përgjithësisht i butë, megjithëse i prirur të jetë shumë i ftohtë në dimër. Në Banja Luka muaji më

Mostari përjeton një sezon relativisht të thatë nga qershori deri në shtator. Pjesa tjetër e vitit është e lagësht, ku reshjet më të dendura bien mes tetorit dhe janarit.

EKONOMIA

Një nga shtyllat më të forta të ekonomisë boshnjake ka qenë gjithmonë industria. Në shumë qytete, si Zenica, Tuzla apo Banja Luka, industria e metaleve dhe përpunimi i qymyrit mbeten burime kryesore të punësimit dhe të të ardhurave. Përpunimi i hekurit, çelikut dhe aluminit, si edhe prodhimi i makinave, pjesëve mekanike

dhe mobileve, janë fusha ku Bosnja ka trashëguar përvojë të gjatë nga perioda e ish-Jugosllavisë. Edhe pse shumë fabrika u dëmtuan gjatë luftës, një pjesë e mirë është rindërtuar dhe sot prodhimet industriale eksportohen në tregjet evropiane.

Në zonat rurale, bujqësia mbetet një pjesë e rëndësishme e jetës ekonomike. Fushat e begata të Bosnjës qendrore dhe të Hercegovinës japin grurë, misër, elb dhe një sërë frutash si kumbulla, molla dhe rrushi. Përveç kësaj, blegtoaria ka një rol të rëndësishëm, sidomos prodhimi i qumështit dhe i mishit, që shpesh shitet në tregjet lokale ose përpunohet në produkte tradicionale. Edhe pylltaria është e zhvilluar, duke furnizuar industrinë e drurit dhe të mobilieve, e cila ka arritur të bëhet një nga sektorët më të suksesshëm të eksportit.

Pjesa më e madhe e të ardhurave ekonomike sot në Bosnje vjen nga sektori i shërbimeve. Tregtia, transporti, turizmi dhe shërbimet financiare zënë vendin kryesor në prodhimin e brendshëm bruto. Qytetet si Sarajeva, Mostari dhe Banja Luka janë kthyer në qendra të rëndësishme tregtare dhe turistike. Vizitorët tërhiqen nga peizazhet malore, nga monumentet historike dhe nga përzierja kulturore që e bën Bosnjën një vend unik në Ballkan. Po ashtu, vitet e fundit janë shfaqur biznese të reja në fushën e teknologjisë dhe të komunikimit, që ofrojnë punë për të rinjtë dhe ndihmojnë në modernizimin e ekonomisë.

GJUHA

Gjuha amtare e shumicës dërrmuese të popullsisë është serbo-kroatishtja. Para viteve 90' atje ekzistonin dy alfabetet, ai latin dhe ai cirilik, dhe të dy mësoheshin në shkolla dhe përdorshin në shtyp, por rritja e nacionalizmit në vitet 1990 shkaktoi një afrim të serbëve me alfabetin cirilik dhe një afrim të kroatëve dhe boshnjakëve me alfabetin latin.

FEJA

Bosnje-Hercegovina është shtëpia e etnive të shumta, por tre janë grupet më të mëdha: boshnjakët, serbët dhe kroatët. Të tre këto grupe ndajnë të njëjtën trashëgimi sllavo-jugore. Dallimi kryesor kulturor midis tyre është ai i përkatësisë fetare - një dallim që mund të shpjegohet nga fakti se Perandoria Osmane që e pushtoi këtë rajon, i lejoi bashkësitë fetare autonome të bashkëjetonin nën sundimin e saj. Në të vërtetë, "serb" dhe "kroat" i referoheshin së pari njerëzve



të dy fiseve sllavo-jugore, dhe pastaj më vonë kryesisht popullit të Serbisë dhe të Kroacisë. Në shekullin e 19-të lëvizjet nacionaliste në Ballkan i inkurajuan boshnjakët që praktikonin ortodoksinë serbe ta prezantonin veten si serbë dhe boshnjakët që praktikonin katolicizmin romak si kroatë.

Ideja e një "kombi" më të gjerë serb ose kroat ishte tërheqëse për udhëheqësit rajonalë që lakmonin territorin e Bosnje-Hercegovinës. Nacionalizmi serb ose kroat u pëlqente edhe boshnjakëve të arsimuar. Më vonë, edhe në mesin e muslimanëve boshnjakë u zhvillua një ndjenjë nacionalizmi, dhe në shekullin e 20-të, termi "musliman" filloi të përdorej si një term identifikimi etnik, jo vetëm fetar, për boshnjakët muslimanë, term i cili në vitet 1990 u zëvendësua nga termi "boshnjak".

Bosnje-Hercegovina është një vend me larmi fetare. Sipas regjistrimit të vitit 2013, muslimanët përbënin 50.7% të popullsisë, të krishterët ortodoksë 30.7%, të krishterët katolikë 15.2%, 2.3% të tjerë, ndërsa pjesa e mbetur nuk ishte deklaruar ose nuk i ishte përgjigjur pyetjes.

HISTORI

Sllavët filluan të vendosen në këtë territor gjatë shekullit të 6-të. Dy fise të fuqishme sllave, kroatët dhe serbët, erdhën atje në një valë të dytë emigrimi, në shekullin e 7-të.

Gjatë shekujve të 11-të dhe 12-të, Bosnja përjetoi sundimin e Bizantit, mbretërisë serbe, Hungarisë, dhe më pas sërish një periudhë të shkurtër të sundimit të ripërtërirë bizantin. Pas vdekjes së perandorit Manuel I Komneni në vitin 1180, sundimi bizantin ra. Nuk u rivendos qeverisja nga Kroacia ose Hungaria, dhe kështu u bë për herë të parë

një territor boshnjak (duke përjashtuar pjesën më të madhe të Bosnjës moderne dhe të gjithë Hercegovinën), si një entitet i pavarur.

Pas ndarjes së vitit 1054 që ndau Krishterimin Perëndimor (Latin ose Katolik Romak) dhe atë Lindor (Ortodoks Lindor), pjesa më e madhe e territorit boshnjak (duke përjashtuar Hercegovinën moderne) ishte latine, por gjatë periudhës së gjatë të izolimit nga Roma, kisha boshnjake ra në ndarjen e saj de facto, duke zgjedhur udhëheqësit e saj nga radhët e krerëve të shtëpive manastirore. Si pasojë e trajnimit të dobët teologjik, praktikave të dobëta dhe praktikave ortodokse lindore, zonat fqinje me Bosnjën (duke filluar nga vitet 1190) patën ankesa të shpeshta se kisha boshnjake ishte e infektuar me herezi ekstreme dualiste të bogomilëve bullgarë. Kështu boshnjakët u zotuan të ndërmerrnin një sërë reformash, por shkalla në të cilën u respektuan këto reforma është shumë e pasigurt.

Ushtritë osmane mësynë Serbinë në vitet 1380 dhe kaluan në Humin (Hercegovinë) të sunduar nga Bosnja në vitin 1388. Mbreti Tvrtko I dërgoi një forcë të madhe për të luftuar kundër tyre së bashku me ushtrinë serbe në Betejën e Fushë-Kosovës vitin pasardhës. Pasardhësi i Tvrtkos, Stjepan Ostojica, luftoi për zotërimin e kurorës kundër vëllait të tij Tvrtko II, i cili u mbështet fillimisht nga turqit dhe më pas nga hungarezët. Fisniku Stefan Vukçiq u angazhua gjithashtu në aleanca taktike kundër sundimtarëve boshnjakë, duke vendosur sundimin e tij mbi territorin e Hunit dhe duke i dhënë vetes titullin herceg (dukë), nga i cili rrjedh emri Hercegovinë. Në vitin 1448 forcat osmane pushtuan një pjesë të rëndësishme të Bosnjës qendrore, të përqendruar

në vendbanimin e Vrhbosnës, nga ku u ngrit "qyteti i Sarajevës". Në vitin 1463 ata pushtuan pjesën më të madhe tjetër të Bosnjës, megjithëse pjesë të Hercegovinës dhe disa zona veriore të Bosnjës u morën nga Hungaria dhe mbetën nën kontrollin hungarez deri në vitet 1520. Vukçiq dhe djali i tij u detyruan gradualisht të largoheshin nga zotërimet e tyre, derisa në duart e turqve ra edhe fortësia e fundit e Hercegovinës.

Bosnja u përfshi me shpejtësi në Perandorinë Osmane dhe u nda në rrethe ushtarake-administrative, ose sanxhaqe (nga turqishtja "sanxhak", që do të thotë "flamur"). Në vitin 1580, një zone të gjerë që mbulonte Bosnjën moderne dhe disa zonave përreth Kroacisë dhe Serbisë iu dha statusi i plotë i një vilajeti ose province përbërëse të perandorisë osmane. Bosnja e gëzonte këtë status si një entitet i veçantë gjatë gjithë periudhës osmane. Vilajeti boshnjak qeverisej nga një vezir dhe administrohej përmes një rrjeti pashallarësh të rinj dhe gjyqtarësh vendas. Toka shpërndahej sipas sistemit feudal osman, në të cilin mbajtësi i një timari (prone) duhej të paraqitej për detyrë ushtarake, duke sjellë dhe mbështetur ushtarë të tjerë, si dhe u vendos një gamë e gjerë taksash.

Përshkrimet e Sarajevës nga udhëtarët që e vizitonin e portretizojnë atë si një nga mrekullitë e Ballkanit... me shatërvanë, ura, shkolla, biblioteka dhe xhami. Xhami të bukura u ndërtuan gjithashtu në qytete të tilla si Foça dhe Banja Luka. (Shumë nga këto ndërtesa u shembën sistematikisht nga forcat serbe në vitet 1992-93.) U shkruan vepra të shumta poezie, filozofie dhe teologjie. Qytetet e Sarajevës dhe Mostarit, ku lulëzoi një kulturë e tillë urbane, gëzonin një shkallë të gjerë autonomie.

Vrasjet që ndodhën në Bosnje-Hercegovinë mes viteve 1941 - 1945 ishin të tmerrshme si në shkallë ashtu edhe në kompleksitet. Është vlerësuar se, kur merren në konsideratë vetëm tre grupet më të mëdha etnike, 164,000 serbë, 75,000 muslimanë dhe 64,000 kroatë vdiqën në Bosnje-Hercegovinë gjatë luftës.

Në vitin 1946, Republika Popullore (nga viti 1963, Republika Socialiste) e Bosnje-Hercegovinës u bë një nga republikat përbërëse të Republikës Federale Popullore (nga viti 1963, Socialiste Federale) të Jugosllavisë. Jeta në Bosnje-Hercegovinë iu nënshtua të gjitha ndryshimeve shoqërore, ekonomike dhe politike që iu imponuan të gjithë Jugosllavisë nga qeveria e saj



QYTETI I MOSTARIT

e re komuniste, por Bosnje-Hercegovina u prek veçanërisht nga heqja e shumë institucioneve tradicionale muslimane, siç janë shkollat fillore kuranore, fondacionet e pasura bamirëse dhe urdhrat fetarë.

Megjithatë, një ndryshim i politikës zyrtare në vitet 1960 çoi në pranimin e termit "musliman" si një term që tregon një identitet kombëtar. Frazja "musliman" në kuptimin etnik, u përdor në regjistrimin e vitit 1961, dhe në vitin 1968 Komiteti Qendror i Bosnjës dekretoi se "muslimanët janë një komb i veçantë". Deri në vitin 1971, muslimanët formonin përbërësin më të madh të vetëm të popullsisë boshnjake. Gjatë 20 viteve të ardhshme, popullsia serbe dhe kroatë ranë në terma absolutë, ndërsa shumë serbë dhe kroatë emigruan. Në regjistrimin e vitit 1991, muslimanët përbënin më shumë se dy të pestat e popullsisë boshnjake, ndërsa serbët përbënin pak më pak se një të tretën dhe kroatët një të gjashtë. Nga mesi i viteve 1990, termi "boshnjak" zëvendësoi termin "musliman" që muslimanët boshnjakë përdorin për veten e tyre si identifikim.

Në vitet 1980, rënia e shpejtë e ekNë vitin 1991, disa të vetëshpallura "Rajone Autonome Serbe" me popullsi të madhe serbe, u shpallën në zonat e Bosnje-Hercegovinës. Dolën prova se Ushtria Popullore Jugosllave po përdorej për të dërguar armë sekrete te serbët e Bosnjës nga Beogradi (Serbia). Në gusht, Partia Demokratike Serbe filloi të bojkotonte mbledhjet e presidencës boshnjake dhe në tetor largoi deputetët e saj nga asamblëja boshnjake dhe krijoi një "Asamble Kombëtare Serbe" në Banja Luka. Deri atëherë, në Kroaci kishte shpërthyer një luftë e plotë dhe shpërbërja e Jugosllavisë ishte në proces. Pozicioni i Bosnje-Hercegovinës u bë shumë i cenueshëm. Mundësia e ndarjes së Bosnje-Hercegovinës

ishte diskutuar gjatë bisedimeve mes presidentit kroat, Franjo Tuđman, dhe presidentit serb, Slobodan Milošević, në fillim të vitit, dhe në nëntor të vitit 1991 u shpallën dy "komunitete kroate" në Bosnje-Hercegovinë veriore dhe jugperëndimore, të ngjashme me "Rajonet Autonome Serbe".

Kur Komuniteti Evropian (KE) njohu pavarësinë e Kroacisë dhe Sllovenisë në dhjetor, ai ftoi edhe Bosnje-Hercegovinë të aplikonte për njohje. Gjatë 29 shkurt - 1 mars të vitit 1992, u mbajt një referendum për pavarësinë. Partia e Karaxhiçit pengoi votimin në shumicën e zonave të populluara nga serbët dhe pothuajse asnjë serb i Bosnjës nuk votoi. Nga gati dy të tretat e elektoratit që hodhën votën, pothuajse të gjithë votuan për pavarësinë, të cilën Presidenti Izetbegović e shpalli zyrtarisht më 3 mars të vitit 1992.

SI ERDHI ISLAMI NË BOSNJE

Pas humbjes së Mbretërisë Serbe në Betejën e Kosovës në vitin 1389, ushtria osmane filloi të afrohej drejt kufijve të Bosnjës dhe Hercegovinës. Qysh në fund të shekullit 14-të, disa qytete kufitare si Zvorniku, Vishegradi e Foça ranë nën ndikimin e sundimtarëve osmanë. Kështu nisi depërtimi i parë i Islamit në këto anë. Megjithëse pushtimi i plotë i Bosnjës ndodhi më vonë - në vitin 1463 - përhapja e fesë së re kishte filluar që më herët, përmes kontakteve tregtare, ushtarake dhe shoqërore ndërmjet banorëve vendas dhe ushtarëve, zejtarëve e administratorëve osmanë. Muslimanët e parë në Bosnje përmenden qysh në fillim të shekullit 15-të. Ndërtimi i xhamive të para në qytete si Zvorniku e Sarajeva, tregon se komuniteti musliman kishte marrë formë që në ato vite të hershme.

Kur në vitin 1463 Sulltan Mehmet Fatihu pushtoi përfundimisht Bosnjën, Islamit iu hap rruga për t'u përhapur në

tërë vendin. Pasi shteti i vjetër i Bosnjës u shua dhe mbreti Stjepan Tomasheviç u dënua me vdekje, Bosnja hyri nën rendin e ri osman. Sulltani vetë nxori një dekret për popullin e Bosnjës, duke u garantuar atyre mbrojtje të jetës, pasurisë dhe fesë, dhe këtë e dëshmon edhe "Ahdnama" që ia dha françeskanëve të Bosnjës, në të cilën shkruhej se askush nuk do t'i dëmtonte dhe se do të ishin të lirë të ushtronin fenë e tyre. Kjo tregon se Islamizimi nuk u bë me dhunë, por në mënyrë të qetë dhe graduale.

Pas pushtimit, administrata osmane solli me vete një rend të ri shoqëror, ku çdo njeri mund të ngrihej sipas meritës së vet, pa u kushtëzuar nga prejardhja. Kjo ndikoi që shumë njerëz, sidomos nga radhët e bogomilëve, të cilët prej kohësh ishin të persekutuar nga kisha katolike dhe ajo ortodokse, ta pranin Islamit me bindje dhe dëshirë. Ata panë në fenë e re një mënyrë për t'u çliruar nga varësia e klerit të mëparshëm dhe për t'u bërë pjesë e një bote më të madhe. Me kalimin e viteve, numri i muslimanëve u shtua ndjeshëm, dhe përveç qyteteve, edhe shumë fshatra filluan të marrin pamje islame. Familjet që pranin Islamit ruanin shpesh emrat e vjetër sllavë për një brez, derisa gjeneratat pasuese merrte emra muslimanë. Dokumentet e regjistrave osmanë të shekullit 15-16 e tregojnë qartë këtë proces natyror, ku në të njëjtin fshat gjejmë njerëz me emra si Pavle dhe Husejn, apo Ivko dhe Jusuf, që dëshmon për kalimin gradual nga feja e mëparshme në Islam.

Kështu pra, Islami në Bosnje nuk erdhi si forcë pushtuese, por si një dritë e re që u përhap përmes shembullit, drejtësisë dhe organizimit të rendit osman. Dijetarët e parë që erdhën nga Anadoli dhe Rumelia themeluan medrese, xhami dhe vakëfe, dhe populli filloi të mësojë fjalët e Kur'anit e të njohë parimet e besimit të ri. Qytetet si Sarajeva, Mostari, Travniku, Foça e Prusaci u kthyen në qendra të kulturës islame dhe dijes, dhe prej tyre doli një brez i ri muslimanësh që e ndërtuan identitetin boshnjak mbi themelet e Islamit dhe gjuhës së tyre vendase. Kështu u vendos dhe u përhap Islami në Bosnje, jo përmes shpatës, por përmes zemrës dhe mendjes së popullit të saj."

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, teologe

<https://en.wikipedia.org>
<https://www.britannica.com>
<https://www.bosanskehistorije.com>
<https://www.worldbank.org>
<https://www.oecd.org>

MYFTIU MBAJTI HYTBEN E XHUMASË NË XHAMINË E KALASË SË DRISHTIT

"Të dashur dhe të shtrenjtë motra dhe vëllezër, në këtë xhami të bukur e të hershme të Kalasë së Drishtit, një vend i cili ka një gjurmë të shënuar në historinë tonë kombëtare, e ku Islami prej shekujsh e shekujsh ka gjetur vend, e ku historikisht zona e Kalasë së Drishtit kanë qenë dhe vazhdon të jetë 100% me përkatësi islame."



Në kuadër të një programi të posaçëm për gjallërimin e jetës fetare në xhaminë e Kalasë së Drishtit, nisi cikli i ri i ligjëratave të ditës së xhuma për periudhën 17 prill - 29 maj 2026.

Sipas programit të afishuar dhe të shpërndarë nga Myftinia Shkodër, ditën e xhuma, më 17 prill 2026, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mbajti hytben e kësaj jave duke vënë theksin tek rëndësia që ka ruajtja e sigurisë, shëndetit dhe mirëqenies në jetën e përditshme të muslimanit dhe shoqërisë në përgjithësi, si tri shtylla të rëndësishme të qytetërimit islam dhe zhvillimi të jetës mbi bazat e udhëzimit dhe besimit islam.

Në hytben e tij, Myftiu i Shkodrës, ndër të tjera tha: "Të dashur dhe të shtrenjtë motra dhe vëllezër, në këtë xhami të bukur e të hershme të Kalasë së Drishtit, një vend i cili ka një gjurmë të shënuar në historinë tonë kombëtare, e ku Islami prej shekujsh e shekujsh ka gjetur vend, e ku historikisht zona e Kalasë së Drishtit kanë qenë dhe vazhdon të jetë 100% me përkatësi islame.

Edhe ajo që të bën me u ndjerë krenar është se nga momenti i parë kur ti shkel në këtë vend ti e ndjen prekjën e gjurmëve të historisë përtej realiteteve të zymta, me të cilat përballet sot kjo zonë thuhet se izoluar dhe e braktisur, jo shumë larg qytetit të Shkodrës.

Përtej këtij realiteti, nga momenti i parë që shkel tek dera e kalasë dhe

vazhdon të vish në drejtim të xhamisë e të takohesh me banorët e këtij vendi, në çdo gur e në çdo cep, ti e ndjen prekjën e Islamit dhe erën e mirë të gjurmës nuranite të burrave të urtë e grave fisnike e sojnikë të kësaj zone e të këtij vendi ndër shekuj.

Mos t'ju duket e çuditshme, sepse besimtari me punën e tij, me kontributin e tij, me angazhimin e tij dhe me përkushtimin e tij; edhe kur largohet nga kjo botë e lë gjurmën e dritës..!"

Myftiu zhvilloi një bashkëbisedim të ngrohtë dhe vëllazëror me besimtarët e pranishëm, si dhe imamin dhe kujdestarin e përkushtuar të kësaj xhamie, H. Isa Muhaj, sikurse shprehu mirënjohjen dhe falënderimet e tij më të thella dhe të Myftinisë Shkodër për shërbimet e imamit, myezinit dhe të gjithë besimtarëve që frekuentojnë këtë xhami.

Vlen të theksohet se banorët e Kalasë së Drishtit janë 100% muslimanë dhe ndër shekuj e kanë trashëguar besimin dhe fenë e tyre, duke ruajtur traditat dhe cilësitë më të vyera të besimit dhe fesë islame.

Sot në Kalanë e Drishtit jetojnë rreth 7 familje me rreth 20 pjestarë, prej 320 të tillë që ishin kohë më parë.

Sikurse theksoi edhe Myftiu në hytben e xhumasë, zona e Kalasë së Drishtit mbetet një zonë e izoluar, e nëpërkëmbur dhe e neglizhuar nga pushtetet e 35 viteve të fundit.

TAKIM DHE VIZITË NË MEJTEPIN E XHAMISË SË FSHATIT KULLAJ, POSTRIBË

Në fillim të muajit prill 2026, teologu Arben Halluni, drejtuesi i sektorit të arsimit pranë Myftinisë Shkodër, zhvilloi një takim dhe vizitë pune në mejtepin e xhamisë së fshatit Kullaj të Postribës, në kuadër të gjallërimit dhe përmirësimit të edukimit dhe arsimit të fëmijëve.

Gjatë kësaj vizite, teologu Halluni mbajti një bisedë të ngrohtë dhe motivuese me nxënësit, duke theksuar rëndësinë e dijes, edukatës dhe përkushtimit në mësimin e vlerave fetare dhe morale. Ai i nxiti fëmijët që



të jenë të rregullt në ndjekjen e mësimave dhe të angazhohen me seriozitet në rrugën e dijes.

Në vijim, u zhvillua edhe një inspektim i ecurisë së programit mësimor, ku u vlerësua puna e mësuesit, H. Ardin Selhani, për përkushtimin dhe angazhimin e tij në edukimin e brezit të ri.

Kjo vizitë vjen si pjesë e angazhimit të vazhdueshëm të Myftinisë Shkodër për të forcuar dhe përmirësuar cilësinë e arsimit fetar në mejtepe, duke synuar formimin e një brezi të edukuar me vlera të shëndosha morale dhe shpirtërore.

EKSKURSION EDUKATIV I NXËNËSVE TË XHAMISË MES-MYSELIM NË KRUIJË DHE TIRANË

Fundjavën që lamë pas, ditën e diel më 12 prill 2026, nxënësit e mejtepit / Qendrës Kulturore të xhamisë "Mes Myselim" zhvilluan një ekskursion edukativ dhe kulturor në qytetet e Krujës dhe Tiranës.

Gjatë kësaj vizite, nxënësit patën mundësinë të njihen nga afër me vlera të rëndësishme historike, kulturore dhe fetare, duke vizituar një sërë objektesh me rëndësi të veçantë, si



kalanë e Krujës, xhamitë e ndryshme, etj.

Ndër ndalesat kryesore ishte vizita në xhamia e Namazgjasë, e cila la mbresa të veçanta tek nxënësit për nga arkitektura dhe dimensionin shpirtëror që të dhuron kjo xhami madhështore.

Ky ekskursion u zhvillua nën shoqërimin e imamit dhe mësuesit, H. Fatmir Sulaj, i cili gjatë gjithë udhëtimit ofroi shpjegime dhe këshilla me vlerë

edukative dhe fetare për nxënësit, duke e kthyer këtë aktivitet në një përvojë të dobishme dhe frymëzuese.

Aktiviteti u realizua nën kujdesin dhe mbështetjen e sektorit të arsimit pranë Myftinisë Shkodër, në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme për edukimin dhe formimin e brezit të ri me vlera të shëndosha fetare, kulturore dhe qytetare.

MYFTIU I SHKODRËS LIGJËROI NË XHAMINË MBRET TË BERATIT

Ditën e diel, më 19 prill 2026, me ftesë zyrtare të Myftiut të Beratit, H. Bilbil Talla, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari zhvilloi një vizitë vëllazërore në qytetin e Beratit.

Fillimisht Myftiu u ndal për një vizitë zyrtare në institucionin e Myftinisë Berat, ku u prit nga Myftiu dhe stafi i tij.

Nëpërmjet një bashkëbisedimi të ngrohtë dhe vëllazëror u diskutua rreth aktualitetit dhe zhvillimit të Thirrjes Islame në vendin tonë, ku dy myftilerët ndanë përvojat e tyre dhe veçoritë e dy qyteteve dhe zhvillimin e jetës fetare në to.

Më pas, Myftiu i Beratit pati mirësinë të shoqërojë Myftiun e Shkodrës në një vizitë shumë të këndshme në disa prej stacioneve më të shënuara të trashëgimisë islame në qytetin e Beratit, si xhamia Mbret, xhamia e Beqarëve, gjurmët e xhamive të vjetra shekullore në kalanë e Beratit, si xhamia e Kuqe, që konsiderohet si xhamia më e vjetër dhe më e lashtë në Shqipëri dhe që i përket një periudhe rreth një shekull para ardhjes së osmanëve në vendin



tonë, gjurmët e xhamisë së Bardhë, etj.

Pjesë e kësaj vizite ishte edhe ligjërata e Myftiut të Shkodrës në xhaminë Mbret, ku në prani të besimtarëve të shumtë, kryesisht të moshave të reja, Myftiu i Shkodrës ligjëroi rreth rëndësisë që ka puna dhe angazhimi i muslimanëve për t'u dëshmuar si ndërtues në realitetet ku jetojnë dhe veprojnë, duke u distancuar nga frymërat e izolimit dhe keqleximit të fesë, si dhe duke u bërë promovues të zhvillimit, përparimit dhe ndërtimit të jetës mbi bazat e besimit dhe përkushtimit të madh.

Gjatë ligjërates së tij Myftiu i Shkodrës solli shembuj të shumtë nga ajetet kur'anore dhe shembujt e pejgamberëve të ndryshëm dhe angazhimit që ata kishin si njerëz ndërtues dhe zhvillues të jetës sipas udhëzimit hyjnor.

Myftiu i Shkodrës uroi besimtarët e pranishëm në xhaminë Mbret për këto ditë të begata të fillimit të dy muajve të Haxhit dhe u lut njëkohësisht për begatinë e tyre, për mbarësi dhe suksese në jetë.



IMAMI I XHAMISË “EBU BEKËR”, H. IDMIR PLAKU, “MIRËNJOHJE” NGA KMSH!



Paraditën e së mërkurës, më 22 prill 2026, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë organizoi një ceremoni nderimi për imamë të spikatur në aktivitetin e tyre në 35 vitet e fundit të organizimit të institucionit më të lartë të muslimanëve në vendin tonë.

Sipas lajmërimit në faqen zyrtare të KMSH-së, mësojmë se: “Komuniteti Mysliman i Shqipërisë zhvilloi sot në ambientet e Tirana International Hotel një aktivitet promovues me rastin e botimit më të ri të institucionit, me titull “Zëri që vjen nga minberi”. Ky botim vjen si një databazë e imamëve

z. Islam Hoxha, nënkryetarët, anëtarë të kryesisë, myftinj, imamë si dhe përfaqësues të shoqatave të ndryshme.”

Pjesë e këtij nderimi për një grup imamësh të përzgjedhur nga mbarë Myftinitë e vendit tonë ishte edhe imami i nderuar i xhamisë “Ebu Bekër” teologu, H. Idmir Plaku.

Në fjalën e tij përpara të pranishmëve, imami i nderuar shprehu falënderimet dhe mirënjohjen e tij për kontributin e madh të imamëve në përgjithësi dhe theksoi se misioni i shenjtë që ata mbartin mbi supe është një amanet që trashëgohet ndër breza dhe që nderon gjithsecilin prej imamëve



që kanë shërbyer nga rihapja e besimit në vendin tonë në vitet '90 e deri në dhjetor të vitit 2025.

Në këtë aktivitet morën pjesë figura të rëndësishme të institucionit, mes tyre Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Kryetari i Këshillit të Përgjithshëm,

kudo qofshin ata.

Në përmbllje të aktivitetit, u shpërndanë certifikata vlerësimi për disa imamë dhe hoxhallarë nga e gjithë Shqipëria, të propozuar nga myftinitë përkatëse, në shenjë mirënjohjeje për kontributin e tyre të çmuar në shërbim të fesë dhe komunitetit.



MËSHIRA E ALLAHUT...!

“

Imam Neveviu po jepte ligjëratë për nxënësit e tij dhe kur mbërriti te fjala e Allahut të Madhëruar: **“Lajmëroji robërit e Mi, se Unë jam Falësi, Mëshiruesi dhe, se ndëshkimi Im është ndëshkim i dhimbshëm!”**

-(Kur'ani, El-Hixhr: 49-50)

Ai ia plasi të qarit dhe nxënësit e pyetën: Çfarë të bën të qash o Imam? Tha: A nuk e shikon mëshirën e Allahut, ku ia atribuon mëshirën dhe faljen Vetes së Tij dhe thotë: **“Unë jam Falësi, Mëshiruesi”** Dhe nuk ia atribuon ndëshkimin Vetes së Tij, por e ka bërë atë posedim të Tij, duke thënë: **“Dhe, se ndëshkimi Im është ndëshkim i dhimbshëm!”**... e nuk ka thënë: *‘E, Unë jam ndëshkuesi!’* Kështu që, kujtova fjalën e Ibn Abasit, kur tha: Allahu e zbrit mëshirën e Tij në ditën e kiametit, derisa edhe iblisi (shejtani) mendon se Allahu do ta falë!

O Zoti ynë, ne të kërkojmë mëshirën Tënde, e cila ka përfshirë çdo gjë, të na mëshirosh me mëshirën Tënde, pas së cilës nuk kemi nevojë, për mëshirën tjetër, përveç mëshirës Tënde!



NË MËSHIRË TË ALLAHUT, H. HIQMET BEKTESHI!

“TË ALLAHUT JEMI DHE TEK AI DO TË KTHEHEMI!”



Myftinia Shkodër shpreh ngushëllimet e saj me rastin e ndërrimit jetë të mësuesit dhe drejtorit të Medresesë “Haxhi Sheh Shamia” (1999 – 2005), z. Hiqmet Bekteshi, i cili ndërroi jetë në moshën 88 vjeçare.

Me këtë rast Myftinia Shkodër shpreh ngushëllimet e saj për familjen Bekteshi, rrethin e gjerë të besimtarëve dhe lutet, që Allahu i Madhëruar ta mëshirojë, ta pranojë veprën e tij dhe ta bashkojë me njerëzit e mirë në xhenetet e Tij në jetën e përtejme.

JETËSHKRIM:

HIQMET BEKTESHI – (1937 – 2026)

U lind më 22.06.1937 në qytetin e Shkodrës.

Drejtor i Përgjithshëm i medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, Shkodër në vitet 1999-2005.

Në vitet 1971-1973 ndoqi studimet në degën “Matematikë-Fizikë”, në Institutin e lartë Pedagogjik të Shkodrës, duke u diplomuar si “Mësues i matematikës dhe i fizikës”, në vitin 1974.


Ka punuar si mësues dhe drejtues shkollash 8-vjeçare dhe të mesme. Për një periudhë 5-vjeçare ka qenë anëtar i jashtëm i Katedrës së Matematikës dhe Fizikës në Universitetin e Shkodrës. Në vitet 1974-1979 ka qenë metodist i matematikës dhe fizikës të rrethit të Shkodrës. Është ndër nismëtarët e Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, ku ka drejtuar konsultat me intelektualë për fizionominë e ardhme të medresesë, duke marrë pjesë edhe në grupin organizator për të gjitha masat e tjera deri në hapjen e Medresesë. Ka punuar si mësues i jashtëm për lëndët Astronomi, Fizikë, në vitet 1991-1995, pastaj mësues efektiv, në vitet 1996-1999 nëndrejtor dhe më 1 shtator 1999 drejtor i Medresesë.

Është vlerësuar dhe dekoruar:

– Me titullin “Mësues i dalluar”, nga Ministria e Arsimit, në vitin 1967.

– Me Urdhrin “Naim Frashëri” të klasit III-të, të klasit të II-të dhe në vitin 1993 me Urdhrin e Lartë “Naim Frashëri” i klasit të parë.

-Titulli “Mirënjohja e qytetit”, nga Këshilli Bashkiak, Shkodër, në vitin 2011.



Pejgamberi (a.s) ka thënë:

“

Pesë gjëra janë prej hakut të muslimanit:

Kthimi i selamit, përgjigjja e ftesës, prezantimi i xhenazes, vizita e të sëmurit

dhe thënia:

“Allahu të mëshiroftë”,

kur teshtitet

dhe thotë:

Elhamdulillah!



(Transmeton Ibn Maxheh, nga Ebu Hurejra)


XHAMIA MË E VJETËR NË EVROPË MBI NJË KODËR QË RUAN HISTORINË E ANDALUZISË



أقدم مسجد في أوروبا
فوق تلة تحرس تاريخ
الأندلس

Nëse xhamitë ndërtohen për Nadhurim, atëherë xhamia Almonaster u ndërta për të ruajtur kujtesën e Andaluzisë në vetvete.

Këtu, mbi një kodër që ruan fshehtësinë e shekujve, janë grumbulluar qytetërimet e romakëve, gotëve dhe



إذا كانت المساجد تشهد للعبادة، فمسجد المنستير شهد ليحفظ
ذكرة قداس لفسها.
هنا، فوق تلة تحرس القرون، تركمت حضارات الرومان والقوط
والمسلمون فسار البناء كلصدة ألف عام من التاريخ الحي، شامها
لا يفرح، وربما لا تلطفون.

myslimanëve. Gurët e ndërimit mbajnë përmbledhjen e një mijë vjet historie të gjallë, si një dëshmitar që nuk plakët dhe një shpirt që nuk shuhet.


Mbi një kodër të lartë mes pyjeve të gështenjave dhe lisave, qëndron xhamia



على تلة عالية وسط غابات الكستناء
والبلوط، يقف مسجد المنستير جنوب إسبانيا
كأقدم مسجد في أوروبا، لم يكن مجرد بناء
للعبادة، بل حصناً يروي قصة خمسة عشر قرناً من
العبور بين الرومان والقوط والمسلمين والمسيحيين.

Almonaster në jug të Spanjës si xhamia më e vjetër në Evropë.

Ajo nuk ishte thjesht një ndërtesë për adhurim, por një fortesë që rrëfen historinë e 15 shekujve të kalimit mes romakëve, gotëve, myslihanëve dhe të krishterëve.



من موسى بن نصير إلى عبد الرحمن
الناصر
مرت جيوش موسى بن نصير بهذه المنطقة الواقعة
قرب إشبيلية، قبل أن يشيدها الأمويون قلعة ومسجداً
في القرن الماشر زمن عبد الرحمن الثالث، من أعلى
التلة، كان المسجد يشرف على القرى ويحمي سكانها من
غارات البرتغاليين طوال قرون.

Nga Musa ibn Nusejr deri te Abdurrahman En-Nasir

Ushtria e Musa ibn Nusejr kaloi në këtë zonë pranë Sevilljes, para se Umejadët (Emevitët) të ndërtonin një kështjellë dhe një xhami në shekullin e 10-të, gjatë kohës së Abdurrahmanit të 3-të.

Nga maja e kodrës, xhamia mbikëqyrte fshatin dhe mbronte banorët e tij nga sulmet portugeze për shumë shekuj.



بناء ولد ثلاث مرات
بدأ مسجد المنستير كمنشأة رومانية في القرن الأول،
ثم كنيسة قوطية في القرن الخامس، ثم مسجداً
أمويًا في القرن العاشر، وبعد سقوط الأندلس عاد
كنيسة في القرن الثالث عشر، كل طبقة معمارية
بقيت شاهدة على زمن، دون أن تُلغى ما قبلها.

Ndërtesë e lindur tri herë

Xhamia e Almonaster filloi si një ndërtesë romake në shekullin e parë, më pas u bë një kishë gotike në shekullin e pestë, pastaj një xhami umajade në shekullin e dhjetë.

Pas rënies së Andaluzisë, ajo u kthye sërish në kishë në shekullin e trembëdhjetë.

Çdo shtresë arkitekturore mbeti dëshmi e kohës së saj, pa e fshirë atë që ishte më parë.



عودة الروح: حين عاد مسجداً بعد قرون
عام 1931م شغل المسجد آثاراً تاريخياً دولياً، ثم أعيد
ترميمه عام 1975م، زعم بطراز عربي بسيط، فتح من
جديد للصلاة، وبقي اليوم المسجد الوحيد في الريف
الإسباني الذي بُني في عهد الأمويين.

Rikthimi i shpirtit: Kur pas Rshkujsh u bë sërish xhami

Në vitin 1931, xhamia u regjistrua si një monument historik ndërkombëtar, ndërsa në vitin 1975 u restaurua.

E rindërtuar me një stil të thjeshtë arab, ajo u hap përsëri për falje.

Sot mbetet xhamia e vetme në fshatin spanjoll që është ndërtaur në kohën e Umejadëve (Emevitëve).

Një ndërtesë që përmbledh Andaluzinë në vetëm 118 metra

Në këtë xhami ndërthuren shtresa romake, gotike dhe islame në një ndërtesë të vetme me sipërfaqe të vogël, por me detaje të mrekullueshme.

Shtyllat e saj i ngjajnë atyre të Kordobës, oborri dhe drita janë të gdhendura në granit, dhe hyrja e saj të çon drejtpërdrejt në një sallë lutjeje fshatare, që pasqyron shpirtin e arkitekturës së hershme andaluziane.



تدمج في المسجد طبقات رومانية وقوطية وإسلامية
في بناء واحد صغير المساحة لكنه بديع التفاصيل،
أعمدته تشبه قرطبة، وحنن وضوءه منحوت في
الجرانيت، ومدخله يفضي مباشرة إلى قاعة صلاة ريفية
تمكس روح العمارة الأندلسية الأولى.

قرية صغيرة.. ومسجد صار هويتها
يعيش نحو 1800 شخص في قرية المنستير لا يزال،
ويعتبرون المسجد ثروتهم ورمزهم وموضع
احتفالاتهم، تعلق القرية لوحات ترشد إليه في كل
الطرق، ويُعقد فيه زفاف المسلمين وغير
المسلمين، وتُنظم حوله فعاليات رياضية وثقافية
سنوية.

Ditë andaluziane... kur fshati kthehet një mijë vjet pas

Për katër ditë çdo tetor, i gjithë fshati kthehet në kohën e Andaluzisë: Vveshje andaluziane, tregje druri, tregim historik, shfaqje me kuaj dhe diskutime mbi bashkëjetesën.

Fëmijët ngjiten në kodër mbi shpinën e gomarëve, dhe xhamia bëhet vend takimi për një dialog kulturor mes Islamit dhe krishterimit.

Burimi: www.instagram.com/tareekhuna_ar



عمارة تختزن الأندلس كلها في 118 متراً
فقط

تدمج في المسجد طبقات رومانية وقوطية وإسلامية
في بناء واحد صغير المساحة لكنه بديع التفاصيل،
أعمدته تشبه قرطبة، وحنن وضوءه منحوت في
الجرانيت، ومدخله يفضي مباشرة إلى قاعة صلاة ريفية
تمكس روح العمارة الأندلسية الأولى.

Një fshat i vogël... dhe xhamia u bë identiteti i tij

Rreth 1800 banorë jetojnë në fshatin Almonaster la Real, dhe ata e konsiderojnë xhaminë si pasurinë dhe simbolin e tyre kryesor, si dhe vendin e festimeve të tyre.

Në çdo rrugë të fshatit ka tabela që të drejtojnë drejt saj, dhe aty zhvillohen edhe dasma për myslihanë dhe jo-myslihanë, si dhe organizohen aktivitete sportive dhe kulturore çdo vit.



عمارة تختزن الأندلس كلها في 118 متراً
فقط

تدمج في المسجد طبقات رومانية وقوطية وإسلامية
في بناء واحد صغير المساحة لكنه بديع التفاصيل،
أعمدته تشبه قرطبة، وحنن وضوءه منحوت في
الجرانيت، ومدخله يفضي مباشرة إلى قاعة صلاة ريفية
تمكس روح العمارة الأندلسية الأولى.

PEJGAMBERI (A.S) KA THËNË:



“

Askush nuk do të lëvizë nga vendi i tij në ditën e kiametit pa u pyetur për katër gjëra:

- 1- JETËN E TIJ,**
si e ka kaluar?
- 2- DITURINË E TIJ,**
çfarë ka punuar me të?
- 3- PASURINË E TIJ,**
ku e ka fituar
dhe si e ka shpenzuar?
- 4- TRUPIN E TIJ,**
si e ka përdorur?

(Transmetuar nga Tirmidhiu)

”



MYFTINIASHKODER1990



www.myftinia-shkoder.org

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org